



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**УСТАВНИ СУД**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, 5 dhjetor 2014  
Nr. ref.: RK736/14

## AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

**Rastin Nr. KI94/14**

Parashtrues

**Sadat Ademi**

**Mospërmbarimi i Aktgjykimit  
të Gjykatës së Apelit në Kosovë, PA1 nr. 966/2013,  
të 27 nëntorit 2013**

## GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar  
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Kadri Kryeziu, gjyqtar dhe  
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

### Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Sadat Ademi, me vendbanim në fshatin Pestovë, Vushtrri.

## Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kérkesës e konteston mospërmbarimin e Aktgjykimit PA1 nr. 966/2013 të Gjykatës së Apelit në Kosovë, të 27 nëntorit 2013, i cili i është dorëzuar atij më 4 dhjetor 2013.

## Objekti i çështjes

3. Pa iu referuar ndonjë nenin konkret të Kushtetutës, parashtruesi i kérkesës pretendon se me vendimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat e tij, pasi që Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në Kosovë, i 27 nëntorit 2013, nuk është përmbaruar në pjesën me të cilën urdhërohet kthimi i një traktori të vjedhur.

## Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës dhe në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

## Procedura në Gjykatë

5. Më 26 maj 2014, parashtruesi i kérkesës e dorëzoi kérkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).
6. Më 10 qershor 2014, Kryetari i Gjykatës me Vendimin Nr. GJR.KI94/14 caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues Gjyqtar raportues. Të njëjtën datë, Kryetari i Gjykatës me Vendimin Nr. KSH. KI94/14 caktoi Kolegjin shqyrtyues të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 20 qershor 2014, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kérkesës dhe kérkoi nga ai informata shtesë, përkatësisht për masat që ka ndërmarrë për të kthyer traktorin, dhe që të sigurojë një kopje të Aktgjykimit PP nr. 628/2012 të Gjykatës së Mitrovicës.
8. Më 5 nëntor 2014, Kolegji shqyrtyues pasi shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues, i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kérkesës.

## Përbledhja e fakteve

9. Parashtruesi i kérkesës nuk i ka përshkruar faktet e rastit. Në vend të kësaj ai deklaroi “*deri më sot nuk jam i kënaqur me vendimet e gjykatës. Tash e mas ju drejtova juve. Shpresoj që kjo Gjykatë të mos punojë dhe të mos bashkëpunoj me hajnat.*”
10. Parashtruesi i kérkesës ka bashkangjitur kopjet e disa dokumenteve nga të cilat mund të nxirren disa fakte.
11. Në të vërtetë, më 1 mars 2012, Dega në Vushtrri e Gjykatës Themelore në Mitrovicë lëshoi një urdhër për sekuestrim të përkohshëm të një traktori të llojit "Massey Fergunson", deri në një vendim tjetër të Gjykatës.

12. Më 19 korrik 2013, Gjykata Themelore (Aktgjykimi P. nr. 112/2012) e shpalli F.B. fajtor për dëmtimin e parashtruesit të kërkesës dhe për marrjen e traktorit të markës "Massey Ferguson". Gjykata Themelore i kishte shqiptuar të akuzuarit F.B. dënimin me një vit burgim dhe e urdhëroi atë "që të dëmtuarit Sadat Ademi në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit tia kthejnë traktorin".
13. Më 27 nëntor 2013, Gjykata e Apelit në Kosovë nxori Aktgjykimin (PA1. nr. 966/2013), me të cilin refuzoi ankesën e të akuzuarit F. B. dhe konfirmoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore.
14. Më 27 qershor 2014, parashtruesi i kërkesës e njoftoi Gjykatën se ai nuk kishte ndërmarrë masa të mëtejme për ta kthyer traktorin e tij. Sidoqoftë, parashtruesi i kërkesës nuk e dorëzoi kopjen e kërkuar të Aktgjykimit PP nr. 628/2012 të Gjykatës së Mitrovicës.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

15. Parashtruesi i kërkesës pretendon që "deri më sot mi kanë shkelur të drejtat e mia, nuk më është kthyer mjeti i vjedhur 'traktori' nuk kam të ardhura tjera."

### **Pranueshmëria e kërkesës**

16. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe Rregullore të punës.
17. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka kërkuar nga gjykata kompetente përbarin e aktgjykimit të Gjykatës Themelore (Aktgjykimi P. nr. 112/2012) të lëshuar më 19 korrik 2013, i cili mori formën e prerë më 27 nëntor 2013.
18. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:  

*"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*
19. Gjykata i referohet edhe nenit 47.2 të Ligjit, i cili parasheh:  

*"Individ mund të ngrejë kërkesën vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*
20. Përveç kësaj, Gjykata po ashtu i referohet rregullit 36 (1) a) të Rregullores së punës, i cili parasheh se:  

*"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: a) janë shterur të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me ligj kundër vendimit ose aktgjykimit të kundërshtuar".*

21. Gjykata vëren se parashtruesi nuk kishte ndërmarrë asnjë masë ligjore për përbarimin e vendimit (PA1 nr. 966 / 2013) të Gjykatës së Apelit në Kosovë, të 27 nëntorit 2013, për të kthyer mjetin e tij motorik.
22. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike efektive sipas ligjit të Kosovës, në mënyrë që Gjykata të vazhdojë me pretendimin e tij për mospërbarim.
23. Gjykata rikujton se, në pajtim me parimin e subsidiaritetit, parashtruesi i kërkesës është i obliguar që të shteroje të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj, siç janë përcaktuar me nenin 113.7 dhe me dispozita tjera ligjore, siç u përmend më sipër.
24. Arsyetimi për rregullin e shterimit është që autoriteteteve përkatëse, duke përfshire gjykatat, t'i ofrohet mundësia për të parandaluar ose për të korrigjuar shkeljen e pretenduar të Kushtetutës. Rregulli bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës do të sigurojë mjete efektive juridike kundër shkeljes së të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të Kushtetutës (shih Aktvendimin për papranueshmëri, *Universiteti AAB-RIINVEST SH.P.K., Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, KI41/09*, parashtrues i kërkesës, i 21 janarit 2010, dhe shih *mutatis mutandis, Selmani kundër Francës*, Nr. 25 803/94, GJEDNJ, Vendimi i 28 korrikut 1999).
25. Rrjedh se, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47.2 te Ligjit dhe rregullin 36 (1) a) të Rregullores së Punës, kërkesa është e papranueshme.

### **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47.2 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) a) të Rregullores së punës, më 5 nëntor 2014, njëzëri

### **VENDOS**

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**Gjyqtari rapportues**

Almiro Rodrigues



**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Prof. dr. Enver Hasani